



Dear all,

It has been a great summer and early autumn in Gjirokastra: the National Folklore Festival, more visitors and ongoing restorations, created a wonderful atmosphere in the City of Stone. GCDO is happy to share with you information on our latest efforts to help save and revitalize Gjirokastra. If you would like to know more, please visit our web-site [www.gjirokastra.org](http://www.gjirokastra.org) or contact the Director, Sadi Petrela by e-mail or telephone 00355 6920 78767.

### 1. US Ambassador signs grant for Gjirokastra Castle Museum



The Ambassador to the United States, Ambassador John L. Withers, has formally handed over \$48,000 towards the first phase of a project to restore galleries in the Castle. This grant (the Ambassador's Cultural Preservation Fund for 2009) will kick start work to create a new multi-purpose space in the Castle, which will double up as a new museum to the

history of the UNESCO World Heritage Site. The museum space will occupy the former Art galleries and is thought to be a multi-functional area where concerts, exhibitions, movie shows and social gatherings can be held. Restoration work on the interior space will start imminently, while work on the design and content of the museum continues this winter. Simultaneously there will be an extensive period of public consultation to determine how the museum should look. Work on repairing the roof of Gjirokastra castle is proceeding well – this project is being undertaken by the Albanian government.

At the same ceremony, Dr. David Packard who has financially supported the work of the GCDO in Gjirokastra for eight years was awarded the title "Honorary Citizen of Gjirokastra". The Mayor Flamur Bime spoke of Dr.Packard's long-lasting commitment to the regeneration of Gjirokastra and said that he was true friend of the city.

### 2. The Third Edition of the National Artisanship and Culture Heritage Fair in Gjirokastra

For the third year on row, Gjirokastra's Old Bazaar welcomed artisans from all over the country on the third edition of the National Artisanship and Culture Heritage Fair. On the 24th and 25th of September, the atmosphere created by both the Fair and the National Folklore Festival overwhelmed the visitors of the Old town and the Gjirokastra community. 70 artisans from Gjirokastra and Albania presented the best of the Albanian art and crafts products. For the first time, a prestigious committee formed of Albanian and international experts selected (using UNESCO's artisan product's criteria for excellence) three winners of the competition "Best Product of the Fair". The first prize was handed to Kristina and Pjetër Përkeqi from Butrint Artisans on the stone mosaic; two second prizes were given to Anastas Petridhi from Gjirokastra on wood carving with Gjirokastra motives and Edlira Sulaj from Tirana on embroidering Albanian Traditional Costumes.

The Fair was organized and funded by GCDO in partnership with the Gjirokastra Municipality, Artisans of Antigonea, the Peace Corps Volunteer (Gjirokastra Group) and the Friendship Association in Gjirokastra.

Përshëndetje të gjithëve,

Ka qenë një verë dhe vjeshtë interesante në Gjirokastrë: Festivali Folklorik Kombëtar, më shumë vizitorë dhe restaurime në vazhdim, krijuan një atmosferë fantastike në Qytetin e Gurtë. GCDO është e lumtur të ndajë me ju të gjithë, informacionet mbi përpjekjet më të fundit për të shpëtuar dhe gjallëruar Gjirokastrën. Nëse doni të dini më shumë, vizitoni [www.gjirokastra.org](http://www.gjirokastra.org) ose drejtojeni drejtorit Sadi Petrela nëpërmjet e-mailit ose në cel 0692078767.

### 1. Nënshkruhet fondi i Ambasadorit të Shteteve të Bashkuara për Muzeun e Kalasë së Gjirokastrës

Në fund të shtatorit u nënshkrua, në prani të ambasadorit amerikan në Tiranë John L. Withers II, marrëveshja për akordimin e fondit prej 48 000 dollarë për Kalanë e Gjirokastrës. Granti, (i cili është fondi i Ambasadorit për Mbrojtjen e Kulturës 2009) do të përdoret për restaurimin e Galerisë së Arteve, ku mendohet të krijohet një muze i ri, që do të pasqyrojë traditat e qytetit dhe luginës së lumit Drino. Restaurimi, në bazë të projektit tashmë të miratuar nga Këshilli Kombëtar i Restaurimit, do të nisë menjëherë, ndërkohë që do vazhdojë puna për mbledhjen e fondeve për konceptimin dhe dizenjimin e muzeut, i cili synohet të ketë formën e një hapësire shumëfunktionale, të përdorshme edhe për aktivitetet të tjera kulturore, si koncerte, shfaqje filmi, ekspozita, mbrëmje galë etj. Për dizenjimin e muzeut do të bëhen konsulta të gjera me specialistë dhe publikun e qytetit. Ndërkohë vazhdon puna për hidroizolimim e tarracës së Kalasë.

Në të njëjtën ceremoni u dorëzua titulli "Nderi i Qytetit" për Dr. David Packard, i cili, në drejtim të Packard Humanities Institute dhe përmes organizatës GCDO, ka mbështetur ruajtjen e vlerave historike në Gjirokastrë. Kryetari i Bashkisë Flamur Bime, duke përshëndetur angazhimet e tij konkrete në rijetëzimin e Gjirokastrës, tha se Dr. Packard është një mik i vërtetë i qytetit.

### 2. Panairi III Kombëtar i Artizanatit dhe Trashëgimisë Kulturore në Gjirokastrë

Më 24 -25 shtator Pazarit karakterist i Gjirokastrës priti për të tretin vit radhazi Panairin e Artizanatit dhe Trashëgimisë Kulturore. Atmosfera e krijuar në rugët e Pazarit, së bashku me Festivalin



Folklorik Kombëtar që u zhvillua në Kala, i dhanë Gjirokastrës një pamje të jashtëzakonshme. 70 artizanë nga Gjirokastra dhe e gjithë Shqipëria paraqitën punimet e tyre më të mira, të cilat, për herë të parë këtë vit, u vlerësuan nga një komision ekspertësh prestigjiozë shqiptarë dhe ndërkombëtarë. Duke bërë vlerësimin në bazë të kriterëve të UNESCO-s për cilësinë, ata shpallën fitues Kristina dhe Pjetër Përkeqin nga Butrinti për mozaikët mbi gur. Dy çmime të tjera u dhanë për Anastas Petridhin nga Gjirokastra për gdhendje në dru dhe Edlira Sulajn nga Tirana për kostumet popullore.

Panairi u financua nga GCDO dhe u mbështet nga Bashkia Gjirokastrë, Artizanët e Antigonesë, vullnetarët e Korpusit të Paqes (Grupi Gjirokastrë) dhe shoqata "Miqësia"

Bizneset e vogla artizane në Shqipëri nuk janë të shumta, me



The artisan small businesses in Albania are not so numerous, with skills concentrated to a handful of artisans and lacking marketing skills. To address these matters and to introduce the concept of Artisan Incubators as a

possible way forward, a round table was organized in the second day of the fair. Experts from SNV, UNDP - UNESCO, Swiss Contact, Gjirokastra Chamber of Commerce were present along with the Fair participants and Gjirokastra Community members. Successful cases of Artisan Incubators were introduced from Afghanistan and Kyrgyzstan. GCDO and partners are working toward opening an Artisan Incubator in Albania.

### 3. Interpretation panels in Gjirokastra Castle

Ten interpretation panels, in Albanian and English, have been placed in Gjirokastra Castle. The panels provide information for visitors to the Castle's main areas of interest and orient them around this great monument. The panels were printed using a new technology for Albania and mounted in the Castle walls in such a way that they do not damage the mortar and materials of the ageing monument. This project was part of a two-years long GCDO program to research the history and building sequences of the Castle and improve the condition of the monument. The results of the final survey have been delivered to the Institute of Monuments of Culture in Tirana, for future use by specialists.

### 4. Second grant from GEF on Gjirokastra Castle



The GCDO has, for the second time (after the illumination of the main Castle Gallery with renewable energy), received a UNDP Global Environmental Facility grant to remove damaging vegetation from the vicinity of the castle. The grant will be used to tackle the spread of the Tree of Heaven (ailanthus altissima) which threatens the biodiversity of the area. Indigenous trees will be planted on the castle slopes to prevent erosion

### 5. Antigonea Trail

Late September saw the formal opening of a new hiking trail linking the Antigonea Archaeological Park with the neighboring village of Asim Zeneli. The trail takes visitors from the Komuna center along a 3.5 kilometer hike to the entrance of the Park. The existing trail, widely used by local shepherds, was widened and cleared and two panels have been erected at the start of the trail providing hikers with information about the route and the Park. The trail was financed and implemented by GCDO in collaboration and support of Antigonea Komune, UNDP - UNESCO program for Culture Heritage and Social & Economic Development, the Archaeological Park of Antigonea and Komune members.

aftësi të përqendruara në një grup të vogël artizanësh të cilët kanë nevojë për kapacitet të përmirësuar tregtimi. Për të trajtuar këto çështje, ditën e dytë të Panairit u organizua tryeza e rrumbullakët "Inkubatorët e Artizanatit si mundësi për rigjallërimin të biznesit të vogël në këtë fushë". Veç artizanëve ishin të pranishëm edhe ekspertë nga SNV, UNDP - UNESCO, Swiss Contact, Dhoma e Tregtisë Gjirokastrë. Ata sollën shembuj të suksesshëm inkubatorësh artizanati nga Afganistani dhe Kirgiztani. GCDO dhe partnerët e saj po punojnë për krijimin e një inkubatori artizanati në Gjirokastrë.

### 3. Tabelat shpjeguese për Kalanë e Gjirokastrës

10 tabela shpjeguese u vendosën në mjediset e Kalasë nga GCDO. Tabelat ofrojnë për vizitorët informacion në dy gjuhë, shqip dhe anglisht për zonat me interes dhe i ndihmojnë ata të orientohen gjatë vizitës në këtë strukturë ndërtimore madhështore. Stampimi i tabelave u bë me



teknologjinë më të fundit në Shqipëri; montimi synoi të mos dëmtojë muret dhe peizazhin arkitektonik të mjediseve të Kalasë. Ky projekt ishte pjesë e një programi dy vjeçar që GCDO ka ndërmarrë në Kala për studimin e historisë arkitekturore të saj, pastrimin dhe zhdukjen e vegjetacionit të dëmshëm në mjediset e saj, si dhe përmirësimin e vizitueshmërisë në Kala. Pjesë e këtij programi ishte edhe studimi i mëtejshëm dhe rilevimi tërësor i Kalasë. Planimetritë e reja të detajuara që u përgatitën me këtë rast u dorëzuan Institutit të Monumenteve të Kulturës, Tiranë për t'u përdorur nga studiuesit dhe restauruesit.

### 4. Granti i dytë i GEF për Kalanë e Gjirokastrës

Pas financimit të projektit për ndriçimin e Galerisë së Madhe të Kalasë së Gjirokastrës me panele diellore, GCDO merr për herë të dytë një fond nga Global Environment Facility. Projekti i ri synon të përmirësojë strukturën e bimësisë në kodrën mbi të cilën është ndërtuar Kalaja e Gjirokastrës. Synohet të shmanget kërcënimi që shënon për biodiversitetin, përhapja e arrës së egër (ailanthus altissima). Për të parandaluar erozionin dhe për të krijuar hap pas hapi një park publik, në kodrën e Kalasë parashikohet të mbillen pemë të llojeve lokale.

### 5. Shtegu turistik për në Antigone

Një shteg turistik i përmirësuar lidh që nga fundi i Shtatorit, fshatin Asim Zeneli me Parkun Arkeologjik të Antigonesë. Shtegu u shërben vizitorëve që parapëlqejnë të udhëtojnë më këmbë për 3.5 kilometra nga qendra e komunës deri në hyrjen e Parkut. Shtegu ekzistues i përdorur nga vendasit, tashmë është zgjeruar, pastruar dhe pajisur me shenja treguese, si dhe tri panele që japin informacion për rrugëtimin dhe vetë Parkun. Projekti u zbatua dhe financua nga GCDO në bashkëpunim me Komunën e Gjirokastrës, Parkun Arkeologjik dhe projektin e përbashkët PNUD/UNESCO "Trashëgimia Kulturore për Zhvillim Ekonomik dhe Shoqëror" dhe mbështetjen e banorëve të Komunës Antigone.



---

## 6. Tourism numbers continue to rise



The spring and summer of 2009, has witnessed a further rise in the number of tourists coming to Gjirokastra. Over 13,000 Albanian and foreign tourists visited Gjirokastra between January – September, a 30% increase compared with the same period in 2008 (these are the statistics from

Tourist Information Center/GCDO in Gjirokastra).

Meanwhile, as a result of a successful training programme implemented by the Tourist Information Centre (supported by the GCDO) and local Peace Corps Volunteers, five local guides were on hand throughout the summer to take tourists on local tours. The TIC made a connection with Intrepid Tours (an international tourist agency) through which the newly trained guides provided tours of Gjirokastra.

---

## 7. A new guidebook for Gjirokastra and its surrounding area



International travelers have now a better chance to understand the values of culture heritage in Gjirokastra and its region. Gjirokastra – the essential guide is the latest publication of GCDO which is successfully distributed in Gjirokastra, Albania and worldwide.

The guide book unravels the complex history of the city and its landscape and details trip into surrounding countryside, where ancient fortresses and medieval churches lie alongside ruins of communist era.

If you want to order the book online, [click here](#).

GCDO is considering opportunities to publish the guidebook in other languages also.

---

---

## 6. Vazhdon rritja e numrit të turistëve

Pranvera dhe vera '09 sollën rritje të mëtejshme të numrit të turistëve në Gjirokastrë. Më se 13 000 turistë shqiptarë dhe të huaj vizituan qytetin e gurtë në periudhën janar-shtator, shifër që shënon një rritje prej 30% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Statistikat janë të Zyrës të Informimit Turistik (ZIT) të administruar nga GCDO.

Këtë verë u bë e mundur që, nëpërmjet një programi trajnimi të ZIT me mbështetjen e GCDO dhe vullnetarëve të Korpusit të Paqes, 5 guida lokale të vihen në dispozicion të turistëve. ZIT hyri në lidhje me Intrepid Tours dhe guidat e trajnuara u punësuan përmes kësaj agjencie turistike ndërkombëtare.

---

## 7. Një guidë për Gjirokastrën dhe rrethinat

Turistët e huaj kanë tani një mundësi më shumë për të njohur dhe kuptuar vlerat e trashëgimisë kulturore në Gjirokastrë dhe rrethinat e saj. Është botimi më i fundit i GCDO libri "Gjirokastra - the essential guide".

Libri po shpërndahet me sukses jo vetëm në Gjirokastrë, por edhe në gjithë Shqipërinë dhe, përmes firmave ndërkombëtare të shpërndarjes së librit edhe në vende të ndryshme të botës.

Libri e udhëheq lexuesin në historinë dhe arkitekturën e jashtëzakonshme të Gjirokastrës dhe përmes disa ekskurioneve, në rrethinat plot me monumente kulture: kala e kisha, që ndodhen pranë rrënojave të epokës komuniste.

Librin mund ta bleni në Zyrën e Informimit Turistik në Gjirokastrë dhe në libraritë kryesore në Tiranë.

GCDO parashikon mundësinë që ta botojë këtë guidë edhe në gjuhë të tjera.

---

If you would like to subscribe to this newsletter send us an e-mail with subject [Subscribe](#).

If you don't want to receive this newsletter anymore send us an e-mail with subject [Unsubscribe](#).